



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH
SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 385 Prot. Datë 23/5 /2018

**PERFORM / HELVETAS SWISS
INTERCOOPERATION**

Nr. _____ Prot. Datë ___/___/2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, person juridik publik, me seli në adresën: Garda e Republikës së Shqipërisë, Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë, Shqipëri, i përfaqësuar nga **Kryetarja, Znj. Gentiana Sula**, më poshtë si “**Autoriteti**”;

dhe

PERFORM – Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga **Helvetas Swiss Intercooperation** në bashkëpunim me Universitetin e Fribourg-ut, me seli të regjistruar në Tiranë, Shqipëri dhe adresë në: Rruga “Donika Kastrioti”, 14, Ap. 15/6L, me NIPT K67303002B, i përfaqësuar ligjërisht nga z. Hans Martin Dietz, në cilësinë e tij si Menaxher i Projektit, më poshtë si “**PERFORM**”;

Nisur prej interesit të përbashkët të përfaqësuesve të Institucionit të Autoritetit dhe të projektit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”), duke patur parasysh në vijim:

Meqenëse Autoriteti është organi kryesor përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe përdorimin e dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit;

Meqenëse Autoriteti është i interesuar për të nisur një proces të bazuar në evidenca mbi reflektimin publik në lidhje me rolin e kërkimit shkencor përgjatë shqyrtimit historik të veprimtarisë së Ish-Sigurimit të Shtetit;

Meqenëse qëllimi kryesor i PERFORM është të lehtësojë fuqizimin e komunitetit të shkencave sociale, me vëmendje të veçantë të mbështetja e iniciativave të ndërmarra nga grupet e studiuesve të shkencave sociale;

Meqenëse Autoriteti dhe PERFORM bien dakord që të bashkëpunojnë për një iniciativë pilot për lidhjen e punës kërkimore arkivore me detyrën e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, si dhe për të nisur një debat publik mbi rolin historik të shkencës në formimin e zhvillimit të shoqërisë shqiptare;

Përmes së cilit është rënë dakord si më poshtë:

1. Kuadri i Bashkëpunimit

Duke pasur parasysh se përballja me kujtesën historike dhe përkujtimi përbëjnë një proces kompleks në vendet ish-komuniste, ekziston ende nevoja për një diskutim gjithëpërfshirës, të informuar dhe objektiv mbi rolin e shkencës dhe historisë në proceset e transformimit shoqëror të Shqipërisë. Kjo duhet të kontribuojë në forcimin e debatit publik mbi politikën kombëtare të kujtesës, duke siguruar qasje të ndryshme dhe dëshmi të vërteta historike. Në këtë kuadër, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit bashkëpunon me PERFORM.

Zbatimi i PERFORM në Shqipëri nisi në fund të vitit 2015. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rrisë rëndësinë e shkencave sociale në shoqëri. Një rezultat i pritshëm specifik është fuqizimi i komuniteteve të shkencave sociale.

Deri më tani, Shqipëria ka ndjekur një proces relativisht të ngadaltë të hapjes së dosjeve të Shërbimit të Ish-Sigurimit të Shtetit (pra dosjet e Sigurimit) dhe nuk ka pasur një debat të bazuar në evidenca në lidhje me mënyrën e trajtimit të së kaluarës komuniste. Përgjatë dy viteve të kaluara, procesi u finalizuar zyrtarisht me miratimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" si dhe me themelimin e Autoritetit si organi publik kryesor.

Vlerësimet aktuale tregojnë se ekzistojnë shumë dosje dhe miliona faqe dokumentesh të trashëguara nga regjimi i mëparshëm. Kjo sasi e konsiderueshme e materialeve arkivore ofron një mundësi të shkëlqyer për studiuesit e fushave të ndryshme që të kryejnë kërkime të thelluara arkivore dhe që të kontribuojnë me evidenca në një debat të forcuar publik në lidhje me procesin e pajtimit të vendit.

Në këtë kontekst, nevoja për të hulumtuar dhe ndërtuar narrativën e rolit të shkencës dhe kërkimit shkencor në zhvillimin e shoqërisë shqiptare në kontekstin e saj historik, si dhe lidhja e saj me proceset aktuale të zhvillimit, janë të një rëndësie të veçantë. Për këtë arsye, PERFORM është i interesuar të mbështesë Autoritetin në kryerjen e një studimi kërkimor arkivor mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954), i cili do të shoqërohet me krijimin e një platforme interaktive komunikimi të aksesueshme nga publiku i gjerë në mënyrë elektronike. Qëllimi i kësaj iniciative pilot është të kontribuojë në krijimin e

themeleve për të nisur me procesin e reflektimit të shoqërisë në lidhje me rëndësinë e shkencës në proceset tranzitore të vendit, si dhe të kontribuojë në lidhjen mes kërkimit shkencor dhe politikës mbi kujtesën historike të Shqipërisë.

2. Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 45/2015 “*Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, neni 17 i Rregullores “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit*”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2014, të Autoritetit.

3. Qëllimi i Bashkëpunimit:

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të mbështesë Autoritetin me kërkime arkivore dhe një platformë interaktive të komunikimit elektronik, për rolin e shkencës dhe kërkimit shkencor gjatë periudhës 1945-1954, në mënyrë që të zhvillohet një proces reflektimi publik i bazuar në evidenca mbi kujtesën historike të Shqipërisë. Kërkimi arkivor do të zgjasë për një periudhë prej pesë muajsh dhe do të marrë formën e dosjeve të profilit të dhjetë shkencëtarëve. Projektimi dhe prezantimi i platformës së komunikimit elektronik do të shtrihet përgjatë një periudhe prej shtatë muajsh dhe do të përfshijë publikimin e rezultateve të kërkimit.

Në këtë mënyrë, ky bashkëpunim synon të kontribuojë në gjenerimin e punës kërkimore ndërdisiplinore, e cila do të mbështesë Autoritetin në përmbushjen e misionit të tij në lidhje me kërkimin shkencor dhe edukimin e qytetarëve mbi rishqyrtimin e historisë së vendit. Qëllimi final është forcimi i bashkëpunimit midis studiuesve të shkencave sociale dhe përfshirja e kërkimeve të gjeneruara për debate publike të bazuara në evidenca. Për këtë qëllim, pritet që Autoriteti ta përdorë këtë eksperiencë pilote për ta përfshirë këtë praktikë në dekadat e tjera të regjimit komunist (1955-1991), për të vendosur një bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e studiuesve dhe për të marrë në zotërim platformën e komunikimit elektronik menjëherë pas përfundimit të bashkëpunimit me PERFORM.

4. Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit

Autoriteti ka për detyrë t'i sigurojë akses ekipit të studiuesve në arkivat e tij si dhe të kontribuojë në shpërndarjen e rezultateve të hulumtimit. Në rast të kërkesës për dokumente arkivore dublikatë do të respektohen kërkesat e nenit 36 e vijues të Ligjit nr.45/2015.

Autoriteti ka për detyrë rast pas rasti, që të angazhojë stafin përkatës për t'u përfshirë në procesin e përzgjedhjes të ekipit të studiuesve dhe ekspertëve të komunikimit, për të ndjekur dhe për t'u përfshirë në lehtësimin dhe zbatimin e marrëveshjes sipas nevojës.

Pas përfundimit të këtij bashkëpunimi, Autoriteti do të përvetësojnë rezultatet dhe mësimet si dhe menaxhimin e platformës interaktive online, gjë e cila do të lejojë vazhdimin e përvojës së lidhjes mes kërkimit dhe politikës mbi kujtesën historike të Shqipërisë.

Autoriteti ka të drejtë të informohet lidhur me funksionimin dhe ecurinë e bashkëpunimit, identifikimin e çështjeve për diskutim të përbashkët dhe të kërkojë në mënyrë aktive reagime lidhur me bashkëpunimin.

Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë palës tjetër informacion lidhur me zbatimin efikas të objektit të Marrëveshjes.

5. Të drejtat dhe detyrimet e PERFORM

PERFORM ka për detyrë të vendosë lidhjet mes Autoritetit dhe produktit kërkimor arkivor, duke përzgjedhur ekspertët e përfshirë të hulumtimit dhe komunikimit, duke i ndihmuar ata me aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve dhe duke garantuar finalizimin e studimeve kërkimore arkivore dhe krijimin e platformës interaktive të komunikimit në kohën e duhur;

PERFORM ka për detyrë të mbulojë kostot në lidhje me studimet kërkimore, me krijimin e platformës dhe me çdo aktivitet në lidhje me to;

PERFORM rezervon të drejtën për të nënkontraktuar çdo detyrë logjistike dhe administrative të lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje te çdo ofrues i tretë shërbimesh;

PERFORM ka të drejtë të mbikëqyrë dhe të jetë plotësisht i informuar për zhvillimin e të gjitha fazave të studimeve kërkimore;

PERFORM ka të drejtë të informohet lidhur me funksionimin dhe ecurinë e bashkëpunimit, identifikimin e çështjeve për diskutim të përbashkët dhe të kërkojë në mënyrë aktive reagime lidhur me bashkëpunimin;

PERFORM ka të drejtë t'i kërkojë palës tjetër informacion lidhur me zbatimin efikas të objektit të kësaj marrëveshjeje.

6. Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të udhëzojë bashkëpunimin ndërmjet PERFORM dhe Autoritetit për periudhën nga momenti i firmosjes deri në nëntor 2018. Sipas rastit, zgjatja e Marrëveshjes do të bëhet me lajmërim paraprak me shkrim dhe me miratimin e tyre të përbashkët.

7. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Të dyja palët në Marrëveshjeje bien dakord që të ngrenë një grup pune i cili do të mbështesë dhe udhëzojë funksionimin e bashkëpunimit.

Të dyja palët angazhohen që të shkëmbejnë informacione me njëra-tjetrën. PERFORM shpreh angazhimin për ta trajtuar informacionin e marrë nga Autoriteti si konfidencial, sipas rastit.

Të gjitha komunikimet lidhur me këtë MB do të zhvillohen në gjuhën shqipe dhe/ose angleze, kryesisht me e-mail ndërmjet personelit të caktuar të Autoritetit dhe PERFORM përkatësisht.

Komunikimi nuk do të kufizohet vetëm në formën e shkruar, por ndërmjet palëve do të zhvillohen takime periodike për të garantuar vijimësinë e bashkëpunimit.

8. Ndryshimi dhe zgjidhja

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga zyrtarët e autorizuar nga palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi. Ai mund të ndryshohet vetëm me shkrim me miratimin e tyre të përbashkët.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi gjatë të gjithë kohëzgjatjes së tij, përveçse nëse ndryshohet ose zgjidhjet nga njeri prej palëve me miratim të përbashkët.

9. Gjuha e Marrëveshjes dhe numri i kopjeve

Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze në 2 (dy) kopje identike për secilën gjuhë, 1 (një) për secilën palë.

Për

Autoritetin për Informimin mbi
Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit

Gentiana SULA

KRYETARE AUTORITETIT



Për

PERFORM
Helvetas Swiss Intercooperation

Hans Martin DIETZ

MENAXHER PROJEKTI

